

# Strategjia për Komunitetin dhe Marrëdhëniet Racore

## HYRJE

Qëllimi i këtij dokumenti është që të na japë mundësi ne në Policinë Britanike të Transportit që të konfirmojmë përkushtimin tonë ndaj komunitetit dhe të japim sqarime se si do të vazhdojmë të përmirësojmë shërbimin që ofrojmë. Në mënyrë që ne ta bëjmë këtë sa më mirë, kemi nevojë dhe kërkojmë mendimet tuaja, të cilat ne i marrim në konsideratë kur përgatisim plane për ruajtjen e sigurisë së hekurudhave.

## NË SHËRBIMIN TUAJ

Ne do të bisedojmë me individë dhe agjensi të ndryshme për t'ju njohur më mirë me kërkesat tuaja, pra të komunitetit tonë. Konsultimet, skemat e partneritetit dhe dhënia e llogarisë (për të cilat jepen hollësi më poshtë) janë jetike për këtë dhe ne po përdorim të gjitha burimet që kemi për të zhvilluar skema partneriteti në mënyrë që të jemi sa më të efektshëm.

Ne kemi përgjegjësi të shumta ndaj jush dhe jemi të interesuar që të vendosim marrëdhënie të mira me ju. Për të udhëtuar në të gjithë vendin apo për të transportuar mallra të ndryshëm disa prej jush përdorin trena, apo mjete të tjera transporti, për sigurinë e të cilave kujdesemi ne si polici. Disa prej jush janë të punësuar në sektorin e shërbimeve, qoftë duke punuar drejtpërsëdrejti në industrinë hekurudhore, qoftë duke ofruar shërbime për llogari të saj. Ose ju mund të jeni një pjesëtar i komunitetit më të gjerë dhe nuk punoni në industrinë hekurudhore por jeni disi të lidhur me të. Ndoshta ju jetoni ose punoni në/pranë një ndërtese që është pronësi e një kompanie hekurudhore, ose jeta juaj mund të ndikohet në një mënyrë apo një tjetër nga hekurudhat.

Cilido qoftë roli juaj, ju mund të jeni një ditë viktimë e një krimi që ka lidhje me hekurudhat, mund të jeni dëshmitarë të një krimi, të lëndoheni apo aksidentoheni, ose mund të dyshoheni për një krim.

Puna jonë ka disa aspekte. Ne duhet të jemi të pranishëm për të ndihmuar komunitetin, veçanërisht ata me aftësi të kufizuara apo personat që sëmuren apo lëndohen gjatë udhëtimit. Ne jemi të përkushtuar që të ndihmojmë familjet apo të dashurit e personave që përfshihen në një krim që ka lidhje me hekurudhat, por ne gjithashtu kemi detyrim që t'ju shërbejmë agjensive të tjera të sistemit të drejtësisë që luftojnë krimin për të mbrojtur interesat e publikut.

## KONSULTIMI

Në mënyrë që ne ta bëjmë sa më mirë punën dhe të përgatisim planet e punës sonë si polici, ne duhet të reagojmë ndaj nevojave tuaja. Kjo është arsyeja që ne ju konsultojmë rregullisht, ose në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi, përmes 'partnerëve' tanë, p.sh. duke organizuar sondazhe të opinionit apo mbledhje të personelit të hekurudhave apo komuniteteve lokale. Pavarësisht nga forma e këtij konsultimi, ne i vlersojmë mendimet tuaja.

## **SKEMAT E PARTNERITETIT**

Një rrjet kompleks skemash të partneritetit na ndihmon të kryejmë detyrën dhe të realizojmë objektivat tona strategjike.

Ne vazhdimisht jemi në kërkim të skemave të reja të partneritetit të cilat na ndihmojnë që t'ju shërbejmë juve sa më mirë. Ne gjithashtu rishikojmë skemat ekzistuese për t'u siguruar që po i përdorim burimet tona duke i shfrytëzuar në maksimum aftësitë që kemi. Një shembull i shkëlqyer i skemave të efektshme të partneritetit është skema Stacione të Sigurta, një bashkëpunim që ne kemi me industrinë hekurudhore dhe qeverinë.

## **LLOGARIDHËNIA**

Ne japim llogari në disa nivele. Për shembull, Shefi i Policisë duhet të japë llogari përpara Komisionit të Policisë dhe përmes tij duhet të japë llogari te partnerët financues të cilët përbëjnë industrinë hekurudhore dhe ofrojnë burimet për ruajtjen e hekurudhave nga policia.

Komandatët tanë të Zonave japin llogari përpara Shefit të Policisë. Ata luajnë një rol kyç në bashkëpunimin me agjensitë e tjera në mënyrë që ne ta kryejmë misionin tonë sa më mirë dhe të përmirësojmë sigurinë e komunitetit. Komandatët e Zonave takohen me përfaqësuesit vendorë të Railtrack-ut dhe kompanive të tjera hekurudhore, operatorë të sistemit të transportit, kompani transporti mallrash etj. Ata marrin pjesë gjithashtu në takimet e Autoritetit të Transportit të Pasagjerëve dhe në takimet e Komisioneve Konsultative të Përdoruesve të Hekurudhave.

Ne gjithashtu u japim mundësi organizatave që kanë lidhje me hekurudhat apo pasagjerët që të diskutojmë bashkërisht tendencat e krimit dhe efektshmërinë e marrëdhënieve tona.

## **ANGAZHIMET <sup>1</sup>**

Ne kemi marrë disa angazhime të cilat kanë si qëllim që të garantojnë që ne të konsultohemi me komunitetin, të punojmë në partneritet dhe të jemi krejtësisht transparentë:

### ***Përmirësimi i partneritetit dhe konsultimit <sup>2</sup>***

Për të shtuar sigurinë tuaj, ne po i përmirësojmë praktikat ekzistuese të punës dhe po vendosim lidhje të reja përmes skemave të partneritetit për të luftuar krimin dhe prishjen e qetësisë si dhe përmes nismave që rrisin sigurinë e komunitetit.

### ***Në mbështetje të udhëtarëve <sup>3</sup>***

Për të ulur nivelin e krimit dhe për të larguar frikën nga krimi në rrjetin e hekurudhave, ne po zhvillojmë konsultime me ju për të identifikuar nevojat tuaja.

### ***Në mbështetje të komuniteteve që janë pranë hekurudhave*** <sup>4</sup>

Ne jemi të interesuar t'ju inkurajojmë që të na ndihmoni në luftën kundër krimit që ka lidhje me hekurudhat. Ne po krijojmë skema partneriteti për t'ju mbrojtur ju, veçanërisht fëmijët dhe ata të rritur që janë më të ekspozuar ndaj krimit në hekurudha, sidomos nga rreziku i hyrjes në pronat private apo vandalizmit.

### ***Krimet me motiv urrejtjeje*** <sup>5</sup>

Ne po bëjmë përpjekje të mëdha për të forcuar besimin që kanë te ne grupet e pakicave etnike, si dhe për të identifikuar dhe parandaluar sulmet raciste, krimin për urrejtje dhe incidentet që shkaktohen nga urrejta apo paragjykimet.

### ***Vlerësimi i shumëllojshmërisë*** <sup>6</sup>

Ne po e kualifikojmë personelin tonë që të jetë i vetëdijshëm për aspektet e shumëllojshmërisë kulturore, seksuale dhe racore, dhe po punojmë që të çrrënjoshim racizmin dhe fanatizmin e institucionalizuar në të gjitha format e tij. Ne vlerësojmë ekzistencën e vlerave të ndryshme brenda organizatës sonë dhe në radhët e komunitetit të cilit i shërbejmë dhe konsultohemi me Grupin tonë të Referencës mbi Shumëllojshmërinë për të gjitha aspektet e hartimit të politikave tona.

### ***Transparenca*** <sup>7</sup>

Ne veprojmë hapur dhe i sqarojmë veprimet tona sa më mirë që të jetë e mundur nga pikëpamja ligjore.

## **MBIKQYRJA DHE VLERËSIMI**

Momentalisht ne po grumbullojmë dhe ruajmë të dhëna për treguesit e përshtatshëm të rezultatit të punës sonë, të cilat do të botohen rregullisht.

Komisioni i Policisë siguron që Inspektori i Madhërisë së Saj për Policinë të rishikojë rregullisht rezultatet e punës sonë. Këto procese na ndihmojnë të identifikojmë të dhënat përkatëse për të vlerësuar punën tonë me synimin që të bëhen përmirësime.

## **INFORMACION SHITESË**

Shefi i Policisë është përgjegjës për këtë strategji e cila mbikqyret nga Ndihmës Shefi i Policisë (Scotland) misioni i të cilit është që ta çojë përpara këtë strategji. Komandantët e Zonave kanë si detyrë që ta zbatojnë këtë strategji në radhët e forcës së policisë.

Për më shumë hollësi rreth Policisë Britanike të Transportit, strukturës sonë dhe Strategjisë sonë për Komunitetin dhe Marrëdhëniet Racore, ju lutemi hyni në faqen tonë të internetit në adresën [www.btp.police.uk](http://www.btp.police.uk), telefononi në numrin 020 7830 8807 ose dërgoni një faks në numrin 020 7830 8870.

## **Shënime**

- 1** Secili angazhim shprehet në një plan veprimi; për informacion të mëtejshëm kontaktoni Zyrën e Komunitetit dhe Marrëdhënieve Racore në numrin 020 7830 8807
- 2** Veprimet drejtohen nga Ndihmës Shefi i Policisë (Scotland)
- 3** Veprimet drejtohen nga Komandantët e Zonave.
- 4** Veprimet drejtohen nga Komandantët e Zonave.
- 5** Veprimet drejtohen nga Ndihmës Shefi i Policisë (Veprimet territoriale) dhe Shefi i Policisë Kriminale.
- 6** Veprimet drejtohen nga Ndihmës Shefi i Policisë (Mbështetja Operacionale)
- 7** Veprimet drejtohen nga Menaxheri i Medias.

British Transport Police, 15 Tavistock Place, London WC1H 9SJ  
telefon falas 0800 405040, postë elektronike: tom.walsworth.btpolice@ems.rail.co.uk  
www.btp.police.uk